

# **STATUTI I “SHOQATES SE BASHKIVE TE SHQIPERISE”**

Ne mbeshtetje te ligjit 7850 date 29/07/1994”Kodi Civil i Republikes se Shqipërisë”; te ligjit 8781 date 03/05/2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7850 datë 29/07/1994” Kodi Civil i Republikes se Shqipërisë”; dhe të ligjit 8788 datë 07/05/2001 “Për Organizatat Jo Fitimprurëse”, hartohet ky statut i “Shoqatës së Bashkive te Shqiperise”

## **PJESA E PARE: DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

### **Neni 1**

Shoqata e Bashkive te Shqiperise, eshte nje shoqate jopolitike, jofetare, jofitimpruese. Shoqata e Bashkive te Shqiperise eshte nje bashkim vullnetar dhe i pavarur i bashkive te Shqiperise .

### **Neni 2**

Emri i shoqatës është “Shoqata e Bashkive të Shqipërisë”.

Shoqata eshte person juridik. Shoqata ka vulen dhe emblemen e saj.

Emblema e shoqates permбан nje prazmore, e cila horizontalisht eshte pershkuar nga shiriti kuq e zi dhe mbi prazmore eshte vendosur nje kurore ne formen e bedenave te nje kalaje.

Vula e shoqates ka gjithashtu te gjithë elementet e siperpermendur te emblemes dhe ne sfondin rrethor te vules shkruhet “Shoqata e Bashkive te Shqiperise”.

Shoqata ka llogarine e vete bankare.

### **Neni 3**

Shoqata e ka seline në Tirane në rr.Ismail Qemali, Pall. i Fratarit, Ap.27 dhe zhvillon aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise.

#### **Neni 4**

Shoqata e ushtron veprimtarine e saj per nje afat kohor te papercaktuar.

### **PJESA E DYTE: QELLIMI DHE FUSHA E VEPRIMTARISE**

#### **KREU I**

#### **QELLIMI I SHOQATES**

#### **Neni 5**

Shoqata e Bashkive te Shqiperise kryen veprimtari bazuar ne legjislacionin shqiptar. Qellimi i Shoqates se Bashkive te Shqiperise eshte te kontribuojë per mbrojtjen e interesave te perbashketa te njesive te vetqeverisjes vendore te qyteteve, me qellim forcimin dhe zhvillimin e strukturave dhe mekanizmave demokratike ne organizimin dhe funksionimin e bashkive dhe zbatimin e parimeve te Kartes Europiane te Autonomise Lokale.

#### **KREU II**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

#### **NENI 6**

Per te arritur qellimin e saj shoqata kryen keto veprimtari:

- a. Mbron interesat e perbashketa te bashkive shqiptare, me qellim arritjen dhe zhvillimin e demokratizimit dhe decentralizimit te vertete te qeverisjes, per arritjen e standarteve europiane te veteqeverisjes lokale, sipas parimeve te Kartes Europiane te Autonomise Lokale.
- b. Vendos lidhje te drejtperdrejta me Kuvendin e R.SH., Qeverine e R.SH, per mbrojtjen e interesave te organeve te vetqeverisjes vendore, duke u bere aktore kryesore ne hartimin e politikave decentralizuese per qeverine vendore.
- c. Perfaqeson bashkite shqiptare ne marrredheniet me organizmat e ndryshme shqiptare dhe te huaja, brenda dhe jashte vendit.

- d. Mundeson diskutimin e problemeve te perbashketa ne forumet e shoqates, me qellim gjetjen e zgjidhjeve praktike, si dhe shkembimin e eksperiencave te ndryshme midis tyre.
- e. Lehteson vendosjen e kontakteve midis bashkive dhe partnereve te tyre jashte vendit, si p.sh. shoqata analoge, institucione nderkombetare, me qellim shkembimin e informacioneve dhe zhvillimin e programeve te perbashketa te bashkepunimit.
- f. Realizon sherbime te ndryshme ndaj bashkive, anetareve te shoqates, duke ofruar trajnime dhe kualifikime per autoritetet dhe administraten vendore.
- g. mundëson diskutimin e problemeve të përbashkëta në forumet e shoqatës, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve praktike, si dhe shkëmbimin e eksperiencave më të mira midis bashkive.

## **Neni 7**

Qellimet e saj, Sh.B.Sh-ja, i realizon me mjete e rruge demokratike.

Per realizimin e qellimeve te saj, shoqata bashkepunon me Kuvendin e Republikes se Shqiperise, Qeverine e Republikes se Shqiperise, Ministrite dhe organizmat e ndryshme qeveritare e jo qeveritare si dhe organizmat nderkombetare qe veprojne ne fushen e vetqeverisjes vendore.

Gjithashtu ajo ndjek edhe veprimtari te tjera per realizimin e qellimeve te saj, te cilat mund te jene:

- a. Veprimtarite e ndryshme njohese e debatuese me anetaret e shoqates;
- b. Botimi i te permuajshmes “Gazeta e Bashkive”;
- c. Kryerja e sondazheve per probleme te ndryshme te perbashketa me anetaret e shoqates;
- d. Sensibilizon opinionin publik nepermjet masmedias, etj.

## **PJESA E TRETE**

### **ANETARESIA E SHOQATES**

#### **Neni 8**

Anetare te Shoqates Kombetare te Bashkive, mund te jene te gjitha bashkite shqiptare, te cilat pranojne statutin e saj dhe qe perpiqen te realizojne qellimet dhe misionin e shoqates, si dhe paguajne rregullisht kuotizacionin.

Bashkite shqiptare, si anetare te shoqates perfaqesohen ne forumet drejtuese te shoqates, nepermjet Kryetarit te Bashkise dhe Kryetarit te Keshillit Bashkiak.

#### **Neni 9**

##### **Anetari i shoqates ka keto te drejta:**

“Anëtari i shoqatës ka këto të drejta:

- të përfaqësohet dhe të zgjidhet në forumet drejtuese të shoqatës sipas rregullave të parashikuara në statut,
- të marrë pjesë në të gjitha veprimtaritë që organizon shoqata
- të informohet rregullisht për ecurine e veprimtarisë së shoqatës,
- të përfitojë nga shërbimet e ndryshme që shoqata kryen për anëtarët e saj”.

#### **Neni 10**

Anetari i shoqates ka keto detyra:

- a. Te marre pjese rregullisht ne mbledhjet e shoqates dhe te shprehe lirisht mendimet e tij per mbarevajtjen e veprimtarise se shoqates, duke bere sygjerime per hartimin e programit te veprimtarive dhe permiresimin e statutit.
- b. Te zbatoje dhe te propagandoje statutin, misionin dhe qellimet e shoqates, duke u angazhuar drejtperdrejt ne permbushjen e objektiveve te saj;
- c. Te paguaje rregullisht nje here ne vit kuotizacionin vjetor nga buxheti i pavarur i bashkise, miratuar nga Keshilli Bashkiak cdo fillim viti, kur miratohet ndarja e buxhetit ne keshill, sipas kushteve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.

## **Neni 11**

Anetaresia ne Shoqate mbaron :

- a. Me largimin vullnetar te anetarit;
- b. Me perjashtimin e tij, kur anetari ka shkelur statutin dhe ka vepruar ne kundërshtim me objektivat dhe qellimet e shoqates. Perjashtimi behet nga Asambleja e Pergjithshme e shoqates, ne prani te 2/3 te anetareve te Asamblese dhe 50% + 1 te votave.

## **PJESA E KATERT : ORGANET E SHOQATES**

### **KREU III**

#### **ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

## **Neni 12**

Asambleja e Pergjitheshme e anetareve eshte organi me i larte i shoqates e cila thirret nje here ne vit, ose kur e kerkon 1/5 e anetareve te shoqates. Ne Asamblene e Pergjitheshme marrin pjese kryetaret e bashkive dhe kryetaret e keshillave te bashkive, te cilet kane te drejte vote te barabarte ne Asamblene e Pergjitheshme.

Vendimet merren me shumicen e votave te antareve qe jane te pranishem ne mbledhje. Ne rastet kur do te trajtohen ndryshime eventuale te statutit ose perjashtimi i nje antari, duhet te jene te pranishem te pakten 2/3 e pjesemarrësve dhe te votohet me shumice te thjeshte.

Ne Asamblene e Pergjitheshme marrin pjese pa te drejte vote te gjithë ish-kryetaret e bashkive si dhe ish-kryetaret e keshillave bashkiake.

Thirrja e Asamblese se Pergjitheshme u behet e ditur anetareve me mjete ose burime te vecanta te pakten 30 dite perpara mbajtjes se Asamblese nga Komiteti Drejtues, i cili miraton paraprakisht materialet qe do te trajtohen ne Asamblene e Pergjitheshme.

## **Neni 13**

Asambleja e Pergjithshme ka keto kompetenca:

- a. Zgjedh Kryesine e shoqates, qe perbehet nga Kryetari dhe dy nen-Kryetaret;
- b. Zgjedh anetaret e Komitetit Drejtues te Shoqates;
- d. Zgjedh anetaret e Komisionit te Revizoreve;
- e. Miraton burimet financiare te Shoqates;
- f. Shqyrton dhe miraton ndryshimet ne statutin e Shoqates;
- g. Vendos per perjashtimin e nje antari sipas kushteve te percaktuara ne kete Statut;
- h. Merr vendim per shperndarjen e shoqates;
- i. Percakton kuoten e antaresise.

## **KREU IV**

### **KOMITETI DREJTUES**

## **Neni 14**

Komiteti Drejtues drejton veprimtarine e shoqates gjate periudhes midis dy Asambleve te Pergjitheshme. Komiteti Drejtues perbehet nga Kryesia e shoqates dhe nga 10% e numrit te pergjithshem te anetareve te shoqates, por gjithmone duhet te jete numer tek. Komiteti Drejtues mblidhet nje here ne kater muaj. Mbledhja e pare e Komitetit Drejtues behet brenda muajit pasardhes, mbas Asamblese se Pergjitheshme. Me kerkese te 1/3 te anetareve te vet, mund te mblidhet edhe me shpesh.

Te gjithe anetaret e Komitetit zgjidhen nga Asambleja e Pergjitheshme, dhe si rregull jane te gjithe kryetare bashkish dhe kryetare te keshillave bashkiake. Kryetari i bashkise se Tiranës eshte gjithmone anetar i Komitetit Drejtues.

Komiteti Drejtues duhet te siguroje perfaqesimin, sipas popullates, larmise gjeografike, forcave politike te angazhuara ne qeverisjen vendore si dhe ruajtjen e raporteve femra-meshkuj. Ne zbatim te kesaj Komiteti Drejtues ka te drejte te zgjedhe ne perberjen e saj deri ne 4 anetare me shume.

## **Neni 15**

Komiteti Drejtues i shoqates ka keto kompetenca:

- a. Aprovon Raportin Vjetor te Shoqates;
- b. Formulon politikat e shoqates
- c. Miraton buxhetin vjetor te aktiviteteve
- d. Pefaqeson shoqaten nepermjet Kryesise se saj ne marredhenie me autoritetet shqiptare ose partneret e huaj.
- e. Organizon dhe ndjek punen per zbatimin e detyrave te caktuara nga Asambleja e Pergjitheshme;
- f. Vendos dhe shpall dhe pergatit mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme;
- g. Merr vendim per pranimin e anetareve te rinj;
- h. Emeron Drejtorin e Shoqates
- i. Emeron Financierin e Shoqates;
- j. Emeron Sekretarin e Pergjithshem;
- k. Zgjedh anetaret e saj shtese, sipas nenit 11 paragrafi 3.

## **KREU V**

### **KRYESIA E SHOQATES**

## **Neni 16**

Kryesia e shoqates perbehet nga Kryetari i shoqates dhe dy Nenkryetare. Kriteret e perzgjedhjes se anetareve te kryesise percaktohen sipas paragrafit te trete te nenit 11, te ketij Statuti.

Kryesia e shoqates drejton Asamblene e Pergjitheshme.

Kryesia, kur e gjykon te arsyeshme, zgjedh grupin perfaqesues te shoqates ne marredhenie me autoritetet shqiptare dhe partneret e huaj. Ne zgjedhjen e ketij grupi Kryesia respekton rregullat e parashikuara ne nenin 14 paragrafi i trete.

## **KREU VI**

### **KRYETARI**

#### **Neni 17**

Kryetari i shoqates ka keto kompetenca:

- a. Kryeson mbledhjet e Komitetit Drejtues;
- b. Perfaqeson shoqaten ne marredhenie me autoritete shqiptare dhe partneret e huaj;
- c. Kryeson Asamblene e Pergjith shme deri ne zgjedhjen e kryesise se re;
- d. Kryetari i shoqates se bashku me kryesine perpilon raportin vjetor te aktivitetit te shoqates.

## **KREU VII**

### **NENKRYETARET**

#### **Neni 18**

Nenkryetaret e shoqates, ne mungese te Kryetarit, kryesojne mbledhjet e Komitetit Drejtues.

Gjithashtu, nenkryetaret me autorizim te Kryetarit te shoqates, perfaqesojne shoqaten ne marredhenie me autoritete shqiptare dhe me partneret e huaj.

## **KREU VIII**

### **FORUMET E PERHERSHME**

#### **Neni 19**

“Forumet e Perhershme” perbehen nga perfaqesuesit e bashkive, te cilet jane specialiste te fushave perkatese.



Forumet e Perhershme mbledhen nje here ne dy muaj.

Keto forume marrin ne shqyrtim dhe sygjerone zgjidhje per ceshtje sipas fushave perkatese te percaktuara si me poshte:

- Forumi i Ekonomise dhe Zhvillimit Vendor;
- Forumi i Infrastruktures dhe Urbanistikes;
- Forumi i Ceshtjeve Sociale dhe Edukimit;
- Forumi i Ceshtjeve Ligjore, Administrative dhe Prokurimit Publik;
- Forumi i Financave Lokale dhe Tatim-Taksave;

## **KREU IX**

### **KOMISIONI I REVIZOREVE**

#### **Neni 20**

Komisioni i Revizoreve perbehet nga 3 persona. Keta jane anetare te shoqates dhe eksperte ne kontabilitet. Ky Komision kontrollon veprimtarine financiare te shoqates, gjendjen e arkës, derdhjet e kuotizacioneve, derdhjet e ndryshme te formes se ndihmave.

Komisioni ushtron kontroll nje here ne vit ne periudhen qe perkon me nje muaj perpara Asamblese se Pergjitheshme.

Komisioni i Revizoreve ka te drejte te kryeje me shume se nje kontroll gjate vit, me kerkese te Komitetit Drejtues.

Komisionit i Revizoreve, informon nje here ne vit Komitetin Drejtues, lidhur me menyren e shpenzimit te mjeteve financiare.

## **PJESA E PESTE: ADMINISTRATA E SHOQATES**

### **KREU X**

#### **DREJTORI EKZEKUTIV**

##### **Neni 21**

Drejtori Ekzekutiv ka keto kompetenca:

- a. Drejton veprimtarine per zbatimin e detyrave te perditshme te shoqates;
- b. Harton planin e aktiviteve te shoqates se bashku me buxhetin perkates dhe ia paraqet per miratim Komitetit Drejtues;
- c. Raporton ne forumet drejtuese te shoqates per aktivitetet e kryera;
- d. Eshte pergjegjes per veprimet administrative te shoqates;
- e. Eshte pergjegjes per rekrutimin e anetareve te stafit pas miratimit te Komitetit Drejtues;
- f. pergatit dhe ndjek mbledhjet e Komitetit Drejtues dhe Forumeve te Perhershme.

### **KREU XI**

#### **STAFI EKZEKUTIV**

##### **Neni 22**

Perberja dhe numri i anetareve te stafit percaktohet me vendim te Komitetit Drejtues. Stafi punon me kohe te plote dhe ekzekuton vendimet e forumeve drejtuese te shoqates.

### **KREU XII**

#### **FINANCIERI**

##### **Neni 23**

Financieri i Shoqates emerohet nga Komiteti Drejtues dhe ka per detyre te mbaje arken, te evidentoje derdhjen e kuotizacioneve dhe burimeve te tjera financiare te shoqates sipas ketij statuti. Ai eshte pergjegjes per veprimet financiare dhe shpenzimet e ndryshme qe kryhen, per realizimin e aktiviteve.

## **KREU XIII**

### **SEKRETARI I PERGJITHSHEM**

#### **Neni 24**

Sekretari i Pergjithshem, pergatit dhe ndjek mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme dhe ne bashkepunim me Drejtorin Ekzekutiv, propozon rendin e dites te mbledhjeve te Asamblese. Gjithashtu mban protokollin ne mbledhjet e Asamblese, si dhe zbardh vendimet qe merr Asambleja e Pergjithshme.

### **PJESA E GJASHTE: MJETET E SHOQATES**

#### **Neni 25**

Mjetet per permbushjen e qellimeve te saj, shoqatat i realizon nepermjet kuotizacioneve nga buxheti i pavarur i bashkise, miratuar nga Keshilli Bashkiak cdo fillim viti, kur miratohet ndarja e buxhetit ne keshill, sipas kushteve te percaktuara nga Asambleja e Pergjithshme.

Burime te tjera jane donacionet e cdo shtetasi qe desheron te kontribuojne per arritjen e qellimeve te shoqates. Gjithashtu burime te tjera mund te jene ndihmat materiale dhe financiare si dhe ndihmat e shoqatave dhe organizmave te ndryshme brenda dhe jashte vendit, sponsorizimet e ndryshme dhe te ardhurat nga sherbimet qe ofron shoqata.

Te ardhurat e realizuara nga shoqata duhet te perdoren vetem per realizimin e aktiviteteve qe parashikohen ne qellimin dhe fushen e veprimtarise, te percaktuara ne kete statut. Nuk lejohet asnje forme e shperndarjes se fitimit ose perfitimit financiar dhe material nga te ardhurat dhe fitimet e shoqates, pervec detyrimeve ne formen e pagave, pagesave, shperblimeve dhe kompensimeve qe rrjedhin nga kontrata e punes ose kontrata te tjera te ngjashme me te , ose per mbulimin e shpenzimeve te kryera me porosi dhe per llogari te shoqates.

Shoqata ka te drejte te kryeje veprimtari ekonomike qe ka si synim arritjen e qellimeve dhe objektive te percaktuara nga statuti. Nqs. nga kryerja e veprimtarise ekonomike, shoqata perfiton te ardhura, ato shpenzohen vetem per qellimet dhe objektivat e parashikuara ne kete statut.

## **PJESA E SHTATE: MBARIMI I SHOQATES**

### **Neni 26**

Shoqata mbaron ne keto raste:

- a. Me vendim te Asamblese se Pergjithshem, te thirrur posacerisht;
- b. Kur qellimi i shoqates eshte permbushur ose nuk ka me mundesi te permbushet;
- c. Me vendim te gjykates kompetente kur shoqata eshte larguar nga qellimi i caktuar ne statut ose kur ajo ka filluar te kryeje veprimtari te kundraligjshme.

### **Neni 27**

Vendimi i Asamblese se Pergjithshme per mbarimin e shoqates merret me 2/3 e votave ne prani te numrit te pergjithshem te anetareve te saj.

### **Neni 28**

Ndryshimet ne aktin themelues dhe statut behen nga Asambleja e Pergjithshme. Vendimi i saj merret me shumice te thjeshte ne prani te 2/3 te numrit te pergjithshem te anetareve te saj.

Vendimet e Asamblese se Pergjithshme qe kane te bejne me ndryshimet ne aktin themelues dhe statutin e shoqates, i paraqiten gjykates brenda 30 diteve, nga data e marrjes se vendimit.

### **Neni 29**

Shoqata ka te drejte te transformohet, te bashkohet ose te ndahet me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Ky vendim merret me shumicen e thjeshte ne prani te 2/3 te numrit te pergjithshem te anetareve te saj.

Vendimi i mesiperm i paraqitet Gjykates Brenda 30 diteve qe nga data e marrjes se vendimit.

### **Neni 30**

Pas marrjes se vendimit per mbarimin e shoqates, Komiteti Drejtues emeron likujdatorin, nga lista e e likujdatoreve ne Gjykate.

Komiteti Drejtues miraton raportin perfundimtar te likujdatorit dhe kerkon nga Gjykata c`regjistrimin e Shoqates.

### **Neni 31**

Ky statut hyn ne fuqi dite e regjistrimit te shoqates ne Gjykatën e Rrethit te Tiranes ne kete dite shoqata njihet edhe si person juridik.